

Deklaratë politike

Unë NEXHAT KRASNIQI që nga paslufta kam qenë aktiv në subjekte politike, fillimisht në PDK, e pastaj në Iniciativën Qytetare të Malishevës, e cila më vonë u shndërrua në Parti Politike, përkatësisht në NISMA PËR KOSOVËN. Unë këtë subjekt politik e kam mbështetur që nga themelimi i tij e deri më 20.08.2017, kur dhashë dorëheqje nga anëtari i këtij subjekti para Kryesisë së nëndegës së NISMA PËR KOSOVËN në fshatin Drenoc. Personalisht jam munduar të jem gjithëherë kritik ndaj dukurive negative...!

Unë konsideroj se pikërisht këto kritika ndaj partive kanë qenë shkaku kryesor që unë nuk kam mundur të depertoj dhe të bëhëm një faktor vendimmarrës institucional për të kontribuar për të mirën e shoqërisë. Medoj se është momenti i fundit kur shoqëria jonë duhet të udhëhiqet nga njerëzit e VULLNETIT TË MIRË dhe PROFESIONAL, të cilët janë të pavarur nga grupet partiake, grupe që udhëheqësit politik i përdorin më shumë për interesa personale sesa për të mirën e përgjithshme të popullit.

Si Kandidat i Pavarur për postin e kryetarit të komunës së Malishevës, do të punoj me përkushtim për ineteresin e përgjithshëm të qytetarëve të komunës së Malishevës dhe absolutisht do të veproj konform Ligjeve dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sepse nuk do t'i kem pas vetes grupet partiake që t'më thonë: " UNË JU KAM PRURË NË POZITEN E KRYETARIT... TANI JU DUHET TË PUNONI PËR NE..."

Të gjithë drejtorët e Drejtorive Komunale, do të jenë ekspertë të fushave që udhëheqin...

Në këtë vend duhet filluar të punohet me logjikën e EVROPIANËVE!

Prishtinë

22.08.2017